

REPUBLICA KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
VENDIMI ËSHTË I PLOTFUGISHËM
GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË NOVOBËRDË
OSHËVNI SËBË GJILANE - DGRANAKA ADVOKAT

28.08.2017
Me

P.nr. 24/2017



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Dega në Novobërdë,
Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqëtarit të vetëm gjykues Islam
Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Syla, në lëndën penale kundër të
pandehurve: El. Q. dhe El. Q. për shkak të veprës
penale, sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga
neni 410 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të cilët i mbrojnë
avokatët: El. Q. dhe El. Q. nga Gjilani, sipas
aktakuzës, PP.II.nr. 635/17, të dt. 27.04.2017, të cilën e përfaqësonë
prokurorja e shtetit Batie Ademi, pas mbajtjes së shqyrtimit filletar, më
datën 12.05.2017, shpalli publikisht, ndërsa më 30.05.2017, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri El. Q., nga baba R. :dhe nëna R. , e lindur
dhe i lindur më R. , në fsh. R. e R. tani me
vendbanim në në fshatin R. , Komuna e Novobërdës, rr. "R."
nr. "R.", ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar- me punë të
përkohëshme në Zvicërr, i martuar , babë i 3 (tre) fëmijëve, i gjendjes së
mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa gjykuar, si
dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

Është fajtor

Sepse më datë 14.04.2017, rrëth orës 15:00h, në territorin e
Komunës së Novobërdës, në afërsi të fshatit R. , përkatësisht në
rrugën R. nr. R. , afér R. , të pandehurit në
bashkëveprim, kanë sulmuar personat zyrtar gjatë kryerjes së detyrës
zyrtare, në shtëpinë e të pandehurit, El. Q. , përderisa nëpunësit e
autorizuar të KEDS-it, L. T. , V. H. , dhe Xhem. M. ishin në
detyrë zyrtare për kontrollimin dhe ndërrimin e njësorëve elektrik sipas
urdhëresës së KEDS-it, nr. 010010 të datës 14.04.2017, nën asistimin e
policisë,

MM

në atë mënyrë që përderisa i dëmtuarit ~~Q. 11~~ punëtor i KEDS-it në Gjilan
ishte duke kryer detyrën zyrtare për ndrrimin e njësorit elektrik në shtëepinë
e të pandehurit, nën asistimin e policisë, i pandehuri E. Q. 11 me
qëllim që ta pamundësoi ndërrimin e njësorit, e sulmon të njejtin fizikisht
duke e shtyer dhe pamundësuar punën, ndërsa më pas vie edhe i
pandehuri E. Q. 11 i cili fillimisht e shtyen me duar nëpunësin e KEDS-
it, më pas zgjatet nga gilinderat dhe e godet me duar dhe
gjuan me sende te forta-këpucë, të dëmtuarin ~~Q. 11~~ e që nga veprimet
e tillë të kundërligjshme të të pandehurve, nëpunësi zyrtar i KEDS-it,
merrë lëndime trupore si pasojë e të cilave është detyruar të kërkojë
ndihmën mjeksore sipas raportit të Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan,
Emergjencia- sipas raportit mjekësor nr.7317, të datës 14.04.2017.

Me këtë në bashkëveprim kanë kryer veprën penale , sulmi ndaj
personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 paragarfi 2
lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Andaj , gjykata duke u bazuar në dispozitën e sipërtheksuar ligjore
dhe neneve 4 , 7, 41 , 49,50,51,52, 73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës e në
lidhje me nenin 365 të KPRK-ës, të pandehurit , i shqipton.

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që të pandehurit E. Q. 11, i shqiptohet dënim me burgim
në kohëzgjatje prej njëqind e njëzetë (120) ditëve, i cili dënim nuk do të
ekzekutohet, nëse i pandehuri, brenda periudhës verifikuese prej dy (2)
viteve, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër
tjetër penale, në të kundërtën dënimini me kusht ka për t'iu revokuar.

I pandehuri detyrohet që në emër të pashallit gjygjësor të arkëtojë
shumën prej tridhjetë (30) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e
plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,nën kërcnimin e përbarmimit të
dhunshëm.

I dëmtuarit ~~Q. 11~~ për realizimin e kërkesës pasurore juridike ,
udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m

PTH.DP në Gjilan ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr. 635/2017 të dates 27.04.2017 kundër të pandehurve: E... m Q... , dhe E... m Q..., për shkak të veprës penale, sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga nenin 410 paragrafi 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së .

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik në të cilën , kanë prezentuar : Prokurorja e Shtetit B... A... ,të pandehurit: E... m Q..., të cilin e ka mbrojtur, avokati E... m Q..., E... m Q..., të cilin e ka mbrojtur aokati E... m Q..., si dhe i dëmtuari punëtor i KEDS-it.

Prokurorja e shtetit pas leximit të aktakuzës në tërësi ka mbetur pranë pretendimeve të theksuara si në dispozitivin e së njëjtës duke i propozuar gjykatës që të pandehurit e sipërtheksuar t'i shpallë fajtorë dhe t'iu shqiptoj dënimin meritor në pajtim me Kodin Penal.

I pandehuri E... m Q..., pasi që u njoftua me aktakuzën përkatësisht veprën panale e cila i vehet në barrë, i njëjtë deklaroit se nuk e pranojë fasinë për veprën penale të cilën ma ngarkon aktakuza.

Ndërsa i pandehuri E... m Q... ka deklaruar e pranoj fajësinë për veprën penale me të cilën më ngarkon aktakuza, në pajtim me përshkrimin faktik si në dispozitiv të së njëjtës.

Meqënse i pandehuri E... m Q... e ka pranuar fajësinë për veprën penale të cilën ia vë në barrë aktakuza, e i cili gjendet aktualisht me punë të përkohëshme në Zvicërr, ndërsa i pandehuri E... m Q... në seancën e shqyrtimit fillestar nuk e ka pranuar fajësinë,gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 36 të KPPRK-së, e me qëllim të efikasitetit dhe moszvarritjes së procedurës penale,ka vequar procedurën penale, për të pandehurin E... m Q... .

Me që i pandehuri E... m Q... në seancën e shqyrtimit të sotëm fillestar, vullnetarisht e pranoi fajësinë, gjykata konstatoi se janë përbushur të gjitha kërkesat për pranimin e fajësisë, konform nenit 248, par. 1 të KPPK-ës , andaj gjykata nuk vazhdoi me administrimin e provave.

Prokurorja e shtetit Batie Ademi deklaron: në shqyrtimin e sotëm fillestari i pandehurit E... Q... e pranoi fajësinë për kryerjen e veprës penale sulmi ndaj personit zyrtar, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe pranimin e fajësisë i pandehuri e bëri me vetëdije të plotë dhe në mënyrë vullnetare pasi që nga ana e gjykatës u njoftua lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pastaj fakti se me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit E... Q... është vërtetuar në tërësi gjendja faktike, ashtu siq është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës lëndore. Kështu që mbetem pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njejta i përban, dhe kërkoj nga gjykata që të pandehurin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj sanksionin e paraparë me dispozitat e Kodit Penal. Në rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës që të ketë parasysh të gjitha rrrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

I dëmtuari ka deklaruar : në tërsi e mbështes fjalën e prokurorës, duke kërkuar kompenzimin për lëndimet të shkaktuara nga i pandehuri.

Mbrojtësi i të pandehurit E... Q... ka deklaruar pas konsultimeve me të mborjturin tim i njejti ka deklaruar se është në gjendje që ta pranoj fajësinë për vepërn penale me të cilën e ngarkon aktakuza, ngase çdo vazhdim i mëtutjeshëm i procedurës penale të njejit do t'i rrezikohej vendi i punës, andaj kërkoj nga gjykata që të njejtit t'ia miratoi pranimin e fajsisw.

I pandehuri E... Q... ka deklaruar: e mbështes në tërësi deklaratën e mborjtësit tim duke theksuar edhe njëherë faktin se e pranoj fajësinë për veprën penale për të cilën më vë në barrë aktakuza.

Pas dëgjimit të fjalëve përfundimtare të prokurorës së shtetit, mbrojtësit të të pandehurit si dhe vetë të pandehurit E... Q... gjykata erdhi në përfundim se te i pandehuri ekzistojnë elementet e veprës penale, sulmi ndaj personit zyrtar, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare nga neni 410 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për çka edhe i njejti është penalisht përgjegjës, andaj gjykata të pandehurin në fjalë e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin si në dispozitin e aktgjykimit.

Me rastin e matjes se dënimit ndaj të pandehurit, gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrëthanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit , ku si rrëthana lehtësuese ka marrë për bazë, pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin dhe kërkim faljen ndaj të dëmtuarit. Ndërsa si rrëthana rënduese gjykata mori parasysh shkallen e përgjegjësisë penale, rrezikshmërinë shoqërore si dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarit.

Sipas bindjes së kësaj gjykate dënim me kusht, sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi është i drejtë në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, dhe konsideron se edhe me këtë dënim me kusht do të arrihet qëllimi i dënimit nga nen 41 të KPRK-së, si dhe ky sanksion penal do të ndikoj në të pandehurin dhe personat tjerë, që në të ardhmen të përbahen nga kryerja e veprave tjera penale.

Shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 par. 1 e lidhur me nenin 450 par. 1 nëpar. 2.6 të KPRK-së .

I dëmtuari, konform nenit 463 të KPPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohen në kontest civil.

Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- DEGA NË NOVOBËRDË
Departamenti i pergjithshëm
P.nr. 24/17 Më 30.05.2017

Sek.juridike,
Rafete Syla ,d.v.



Gjyqtari i vetëm gjykues
Islam Thaçi, d.v.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, departamenti i pergjithshem në afat prej pesmbëdhjetë (15) ditëve, nga data e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje te mjaftueshme i dorëzohet kesaj Gjykate Themelore .

